



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT



### AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH- SIGURIMIT TË SHTETIT

### SHOQATA KOMBËTARE ANTIKOMUNISTE E ISH-TË PËRNDJEKURVE POLITIKË TË SHQIPËRISË

Nr. 1129 Prot.

Nr. 131 Prot.

Tiranë, më 09.07 2024

Tiranë, më 09.07 2024

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, me adresë Adresa: Rruga e Dibrës, Garnizoni “Skënderbej”, Tiranë, Njësia Administrative nr.4, [www.autoritetidosjeve.gov.al](http://www.autoritetidosjeve.gov.al), e-mail: [info@autoritetidosjeve.gov.al](mailto:info@autoritetidosjeve.gov.al), (më tej referuar si “AIDSSH”/“Autoriteti”), përfaqësuar nga Kryetarja Dr. Gentiana Sula

dhe

Shoqata Kombëtare Antikomuniste e Ish-të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë (referuar më tej si “Shoqata”/“SHKAPPSH”), përfaqësuar nga Kryetari z. Ethem Fezollari,

Nisur prej interesit të përbashkët që të dy institucionet kanë, rrjedhur prej veprimtarisë dhe përcaktimave që bëhen në aktet themeluese dhe rregulluese përkatëse, palët merren vesh që të lidhin një marrëveshje bashkëpunimi me përbajtje si në vijim:

## **Neni 1**

### **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është vendosja e urave të bashkëpunimit në fushën e kujtesës, për rivlerësimin e personaliteteve dhe ngjarjeve historike, si dhe kontributi në njohjen e së shkuarës, nëpërmjet hapësirave e mundësive për ballafaqim me dosjet dhe historitë e komunizmit, për edukimin e brezave të rinj dhe zhvillimin e dialogut të shëndetshëm shoqëror, në emër të një të ardhmeje më të mirë.

## **Neni 2**

### **Objekti**

Objekti i kësaj marrëveshjeje është institucionalizimi i marrëdhënieve për bashkëpunimin e ndërsjellë të palëve, në kuadër të identifikimit, grumbullimit, administrimit dhe studimit të dokumenteve e të materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit të periudhës 29 nëntor 1944 – 2 korrik 1991 lidhur me persekutimin e vuajtur nga ata individë dhe nga të afërmishtë e tyre, që sot konsiderohen “ish-të përndjekur politikë” në Shqipëri.

Me këtë marrëveshje synohet dhe bashkëpunimi në fushën studimore, kujtesën kolektive dhe ndërgjegjësimin për të shkuarën, që hedhin dritë në krimet dhe pasojat e diktaturës së proletariatit në Shqipëri dhe periudhën kur ka funksionuar ish-Sigurimi i Shtetit.

## **Neni 3**

### **Baza ligjore**

Baza ligjore e kësaj marrëveshjeje është ligji nr. 45/2015, “*Për të drejtën e Informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*”, i ndryshuar; Ligji nr. 119/2014, “*Për të drejtën e Informimit*”; Ligji nr. 9380, dt. 28.04.2005 “*Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të*”; Ligji nr. 9154/2003, “*Për arkivat*”; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 93, datë 27.02.2019, “*Për përcaktimin e tarifave dhe të pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit*”; Rezoluta e Parlamentit Evropian mbi rëndësinë e një kujtese të përbashkët evropiane (2019) dhe parimet ndërkombëtare të Rrjetit Evropian të Kujtesës dhe Solidaritetit; Rezoluta nr.11 “*Për dënimin e kimeve të kryera nga regjimi komunist në Shqipëri*” (2006) dhe Rezoluta “*Për dënimin e kimeve të komunizmit ndaj klerit, si dhe mirënjohjen e veçantë për rolin dhe veprimtarinë e klerikëve në mbrojtje të vlerave demokratike dhe të drejtave dhe lirive themelore të njeriut*” (2016), të Kuvendit të Shqipërisë; Neni 17 i Rregullores “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit*”, miratuar me Vendimin nr. 96, datë 12.02.2024, të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

## Neni 4

### Sfera e bashkëpunimit

AIDSSH dhe Shoqata angazhohen të bashkëpunojnë për përpunimin dhe trajtimin e çështjeve themelore që kanë të bëjnë me ish-të pérndjekurit politikë, veçanërisht për vendet e kujtesës, e ekzekutimit dhe të vuajtjeve të dënitit, si dhe në aktivitetet përkujtimore të organizuara prej secilës palë, sipas programeve të miratuarë në bashkëpunim dypalësh ndërmjet dy institucioneve, që bëjnë pjesë në fushën e veprimtarisë së tyre.

## Neni 5

### Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Në përbushje të kësaj marrëveshjeje, **Autoriteti** dhe **Shoqata Kombëtare Antikomuniste e Ish-të Pérndjekurve Politikë** të Shqipërisë kanë të drejta dhe detyrime, dhe angazhohen të bashkëpunojnë në fushat e tyre të kompetencës dhe të misioneve, si më poshtë:

Në përbushje të kësaj marrëveshjeje Autoriteti dhe Shoqata kanë këto të drejta dhe detyrime:

1. Grumbullimin e të dhënavës dhe dokumenteve për njohjen e veprimtarisë së organeve të ish-Sigurimit të Shtetit, të formave të persekutimit dhe të formave të rezistencës kundër tyre, si dhe veprimtarinë që kanë çuar në dhunimin e të drejtave dhe të lirive të njeriut në vitet e regjimit komunist në Shqipëri;
2. Grumbullimin e të dhënavës dhe dokumentacionit arkivor të ish-Sigurimit të Shtetit dhe ta bëjë të disponueshëm, kundrejt kërkesave, pa pagesë. Shoqata angazhohet të referojnë Autoritetin në studimet e kryera, si dhe te depozitojnë pranë Autoritetit kopje të studimeve.
3. Bashkëpunimin me studiues, të cilët do të bëjnë studime afatgjata lidhur me figurat e pérndjekura dhe të dënuara gjatë regjimit komunist;
4. Hartimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta me Shoqatën Kombëtare Antikomuniste e Ish-të Pérndjekurve Politikë të Shqipërisë;
5. Bashkërendimi i punës për edukimin qytetar nëpërmjet garantimit të mundësive për shqyrtimin e dokumenteve të organeve të diktaturës komuniste, duke përfshire dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit të asaj periudhe;
6. Pasurimin e narratives së historisë '44-'91;
7. Angazhimin e të dyja palëve në fushën e kërkimit shkencor dhe punës studimore, si mbledhje faktesh, hulumtimin, ndërtim profilesh njerëzore, shkrime artikujsh shkencore dhe informues, fushata sensibilizuese, monitorime dhe veprimtari të tjera ndërgjegjësuese;
8. Të shkëmbejnë planet vjetore dhe kalendarët e aktiviteteve që dy institucionet miratojnë;
9. Të bashkërendojnë punën që lidhet me vendet e kujtesës, të ekzekutimit, dhe të vuajtjes së dënitit politik me burgim dhe vuajtjes së dënitit në kampet e internimit;
10. Të mbështesin me burimet njerëzore që ka secili institucion për kërkimin shkencor gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit;
11. Të organizojnë, të hapin ose të shkëmbejnë ekspozita që kanë si bazë pasurinë dokumentare apo kulturore në fushat respektive që dy institucionet mbulojnë sipas rregullimeve përkatëse ligjore;

3. Vështirësitë e paparashikuara, mosmarrëveshjet ose mospajtimet, që rezultojnë nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, do të zgjidhen nëpërmjet bisedave në mirëbesim, me negociata midis palëve. Në rast se një mirëkuptim i tillë është i pamundur që të arrihet, do të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Neni 12**  
**Afati i marrëveshjes**

1. Marrëveshja do të lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar.
2. Marrëveshja mund të përfundojë nga secila prej palëve nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim drejtuar palës tjetër, të paktën një muaj përpara.
3. Në rast të përfundimit të kësaj marrëveshjeje palët do t'u përbahen detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje, përsa i përket informacionit dhe të dhënavë të shkëmbryera përpara datës së përfundimit të saj.

**Neni 13**  
**Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi**

1. Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.
2. Marrëveshja është hartuar në Tiranë, në katër kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe dy të tjera në Shoqatën Antikomuniste të Ish-të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë.

PËR

Autoritetin për Informimin mbi  
Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Dr. Gentiana Sulaj  
*Gentiana Sulaj*  
Kryetare e Autoritetit  
*[Handwritten signature]*



PËR

Shoqatën Antikomuniste të  
ish-të Përndjekurve Politikë  
të Shqipërisë

Z. Ethem Fezollari  
*Ethem Fezollari*  
Kryetar i Shoqatës  
*[Handwritten signature]*